



**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova  
 Republic of Kosova



**Kuvendi Komunal Prizren**  
 Skupstina Opstina Prizren  
 Municipal Assembly Prizren

## **KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE** **2025 - 2027**

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Prizrenit, është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2025-2027, të dhëna nga MFPT (Ministria e Financave Punës dhe Transfereve) përmes Qarkores buxhetore 2025/01 për Komunat si dhe financimi nga grandet ndërqeveritare dhe kufijtë fillestar të buxhetit komunal për vitin 2025 dhe parashikimet për 2026-2027. Ky dokument i ka kushtuar rëndësi të veçantë alokimit të buxhetit nga aspekti i barazisë gjinore. Korniza afatmesme buxhetore ( KAB ) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Me Kornizën Afatmesme Buxhetore – Komunale, do të paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetëve duke u bazuar në komponente barazisë gjinore duke marrë parëse nevojat e grave dhe burave gjatë planifikimit nga aspektet e punesimit, perfituesve të bursave , participimin në vendimarrje në projekte të ndryshme, kultura, subvencionet, pjesëmarrje në degjime publike etj. të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Prizrenit, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush dhe përkrah projektet me prioritet, duke promovuar rritjen e mirëqenies sociale dhe familjare me fokus të veçantë në grupet në nevojë dhe barazinë gjinore që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2025– 2027 gjithnjë duke u bazuar në :

- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
- Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

## I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantojmë është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike duke marrë për bazë nevojat grave dhe burrave dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivat prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritimit sa më të mirë në procesin buxhetor. KAB promovon rritjen e mirëqenies sociale përmes zgjerimit dhe ngritjes së cilësisë, ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, me fokus të veçantë në grupet në nevojë dhe barazinë gjinore. Kjo është në përputhje me KASH-in.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2024-2026 të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2025-2027. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



## Prioritet e Komunës

### II

#### 1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi te barabarta për të gjithë

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi të standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirsim, bursa për studime, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë përmes subvencionimit e grave dhe burrave fermere.
- 

#### 2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile me theks te vecante te gratë dhe grupet ne nevojë
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive per vajza dhe djem.

#### 3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

Ne baze te hulumtimit te nevojave te grave dhe burrave Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigjenerimit të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimi të standardeve të ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara
- Ofrimi i mundësive per pjesëmarrje aktive te grave dhe grupeve ne nevojë;

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

#### 4. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve dhe nevojave te grave dhe burrave.

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve (burrave dhe grave) duke u fokusuar qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

Ndërtimit dhe rekonstruimit të zyreve komunale (të gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të ofrimit të shërbimeve per gratë dhe burrat

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2025-2027 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

## II. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtë për drejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025-2027 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike siç janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë të grave dhe burrave në Komunë, që në periudhën afatmesme pritet të ulet, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative**. Komunitat po ashtu janë pranuese të **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Prizrenit në periudhën afatmesme buxhetore 2025-2027 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, sic e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

## ❖ OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2025 – 2027 planifikohet në bazë të Buxhetit i cili bazohet në “Buxhetin e Programeve “ dhe është i orientuar në objektivat dhe në deklarata të Misionit të Programeve . KAB 2025 – 2027 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr. 2025/01 e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritet e programeve .

Është pjesë përbërëse e KASH-it të Republikës së Kosovës. Karakteristikë tjetër e buxhetit të tashëm është përfshirja e “Kornizës afat mesme të shpenzimeve”. Kjo na ka mundësuar që të Planifikojmë të hyrat dhe shpenzimet jo vetëm për vitin pasus, por edhe për dy vite të ardhshme. Ajo që tani na duhet është definimi i “ Misionit tonë” së paku për tri vite tjera të kthyer në objektiva, programe, veprime dhe shifra.

Misioni i komunes eshte qe te promovon dhe ofron zhvillim dhe rritje te mireqenies se qytetareve duke ruajtur dinjitetin njerëzor dhe duke ofruar sherbime sa ma cilesore ,ne kohe dhe te barabarte per te gjithë, te ndjeshëm per nevojat e grave dhe burrave.

### Deklarata e MISIONIT

Misioni i komunes eshte qe te promovon dhe ofron zhvillim dhe rritje te mireqenies se qytetareve duke ruajtur dinjitetin njerëzor dhe duke ofruar sherbime sa ma cilesore ,ne kohe dhe te barabarte per te gjithë, te ndjeshëm per nevojat e grave dhe burrave.

### ❖ Objektivat e Komunës së Prizrenit:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit
- Hartimi i planit zhvillimor të Komunës dhe planeve rregullative në zonat urbane
- Kthimi i të zhvendosurve në prona të veta
- Zhvillimi i sferës së Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale
- Ngritja e nivelit të Arsimit dhe Edukimit
- Zhvillimi i sferës së Kulturës, Sportit dhe Rinisë
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme
- Përmirësimi i nivelit të kooperimit ndëretnik
- Zhvillimi i turizmit kulturor, historik dhe malor
- Riatdhesimi i qytetarëve të kthyer.

### Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

#### Objektivi i përgjithshëm:

- **Krijimi i politikave dhe programeve kulturore, rinore dhe sportive që gjatë hartimit dhe zbatimit te tyre te behet promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave;**

### Objektivi specifik:

- **Sigurimi i mjediseve te favorshme per zhvillimin e aktiviteteve sportive te vajzave dhe grave duke mundesuar rritjen e pjesemarrjes se tyre ne jeten sportive, dhe tejkalimin e normave diskriminuese sociale.**

### Indikatori:

- **Të nxitet krijimi i klubeve sportive vetëm për gra dhe vajza, ku në vitin 2022 ishte vetëm një klub i udhëhequr nga gratë, në vitin 2023 numri u shtua në 2, deri në vitin 2025 të jenë së paku 5 klube sportive të udhëhequra nga gratë dhe vajzat.**

### Drejtoria e Bujqesise

#### ➤ **Objektivi strategjik**

- Përmirësimi i dhe koordinimi i politikave komunale me qëllim të Inkurajimit të vazhdueshëm dhe mbështetjes së programeve për pjesëmarrje dhe përfitimeve të barabarta për gratë dhe burrat në sektorin e Bujqësisë në një nivel lokal, përmes promovimit të rëndësisë së rolit të grave në zhvillimin e bizneseve bujqësore ,pronësisë së tokës nga gratë, mbështetjes financiare për gratë për të filluar ose zhvilluar biznese vetanake bujqësore si dhe ofrimin e trajnimeve të specializuara për të përmirësuar aftësitë e tyre bujqësore dhe menaxheriale.

- Sqarim: Kjo do të ndihmojë të sigurohet që gratë dhe burrat të kenë një pjesë të barabartë në përfitimet dhe pjesëmarrjen në sektorin bujqësor në nivel lokal, e cila do të përmbushet nëpërmjet një sërë masash dhe politikash të orientuara drejt përmirësimit të barazisë gjinore në të gjitha aspektet e zhvillimit dhe menaxhimit të sektorit bujqësor.

#### ➤ **Objektivi i pergjithshëm**

- Promovimi dhe mbështetja e grave dhe vajzave nga zonat rurale dhe sigurimi i programeve të ndryshme për fuqizimin e tyre me njohuri dhe shkathtësi në sferën e bizneseve bujqësore si dhe këshillime rrethë zhvillimit të vizionit për hapje të bizneseve, rrjetizimi i bizneseve te grave si dhe aksesin në burimet financiare dhe teknologjike;

#### ➤ **Objektivi specifike**

- Përmirësimi i përfaqësimit të grave dhe burrave në organet vendimmarrëse dhe **komisionet perzgjedhëse-vleresuese** të nivelit lokal të lidhura me sektorin e bujqësisë, përfshirë këshillat bujqësore dhe komitetet për zhvillim rural.

#### ➤ **Indikatori gjinor**

**Pjesëmarrja në vendimmarrje:** Të rritet përqindja e grave në raport me burrat në vendimmarrje dhe komisionet perzgjedhëse që kanë të bëjnë me politikën bujqësore lokale, si **planifikimi i Strategjis së zhvillimit të bujqësië**

## ❖ Objektivat shtetërore

- Përkrahjes dhe krijimit të parakushteve për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik; rritja e numrit të grave përfituese të subvencioneve komunale për 10% me vlerë (te shtohet vlera) në raport me 2024 (te ceket sa ka qene vlera e subvencioneve që i kanë përfituar grat).
- Qeverisjes së mirë dhe fuqizimit të sundimit të ligjit; Rritja e numrit të grave të punsuara për 10% në raport me vitin 2024. (në kushte barabarta përparsi për grat) (këtu te shtohet % ekzistuese të punësuarve femra dhe meshkuj për vitin 2023)
- 
- Zhvillimit të kapitalit njerëzor; si dhe potencialin gjithëanshem të grave dhe burrave. / Rritja e numrit të përfituesve të bursave studentore për 50% femra meshkuj në raport me vitin 2024. (këtu te shtohet 5 e përfituesve femra dhe meshkuj)
- **Krijimi i infrastrukturës së pershtatshme për zhvillimin e aktiviteteve Kulturore, Rinore dhe Sportive: Ndërtimi i objekteve të ndryshme në baze të nevojave burrave, grave, vajzave dhe djemve duke mundësuar qasje të barabarte në shfrytëzim);**
- Rritjes së mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Banimi social, mbështetja financiare për strehimoren e grave (vazhdimi i marveshjes memorandum mirekuptimi) funksionalizim i shtepise se pleqve.
- Mbështetje lehonave.

Siq mund të shihet objektivat e Komunës janë të lidhura ngusht me objektivat e shtetit të Kosovës

### **Ky dokument ka për qëllim të:**

- Promovojë disiplinën fiskale dhe të prezantojë vlerësime reale mbi nivelin e të hyrave buxhetore.
- Të prezantojë politikat fiskale në funksion të implementimit të politikave prioritare të Qeverisë.
- Të sigurojë një ambient të qëndrueshëm makroekonomik, në funksion të zhvillimit të sektorit privat.
- Të përcaktojë kufijtë e shpenzimeve me qëllim që të sigurojë nivel të ulët të deficitit fiskal.

**Objektivat:****a). Shtimi i efikasitetit gjatë operacioneve**

- Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur
- Përzgjedhja e punëve më prioritet për realizim

**b). Rritja e shpejtë e të ardhurave**

- Rritja e efikasitetit në inkasim
- Zgjerimi i bazës tatimore

**c). Kontrolli i shpenzimeve dhe reduktimi i shpenzimeve**

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë
- Përparësia nga blerja me shumicë
- Përmirësimi i specifikimit për mallra dhe shërbime
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat me afat të gjatë

**d). Zhvillimi i aftësive**

- Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore
- Përdorim i gjerë i kompjuterit
- Profesionalizimi i shërbimeve

**e). Të sigurohet disiplina financiare**

- Pajtueshmëria me politikën financiare, rregullat, rregulloret dhe me udhëzimet
- Ekzistenca e kontroleve interne – Auditori i Brendshëm
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik
- Analizat të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve
- Realizimi i Buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme ( Cash Plani )



## f). **Ekonomia**

- Zhvillimi i strategjisë Komunale për promovim ekonomik
- Krijimi i kushteve për investime të huaja
- Strategjia për zhvillimin rural

### **Programet**

#### **a. Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparencë**

- Përmirësimi i politikës së prokurimit dhe procedurat
- Shënimet e duhura financiare dhe procedurat e kontabilitetit
- Inventarizimi i duhur dhe menaxhimi i pronës
- Koordinimet në mes departamenteve
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat Gjenerimi i statistikave gjinore
- 
- Menaxhimi i bazës së të dhënave dhe përhapja e informatave

#### **b. Përmirësimi i bazës së të ardhurave**

- Arkëtim më të madh të tarifave dhe ngarkesave që janë për t'u paguar
- Sa më shumë tatimpagues në rrjetin e tatimeve
- Ngarkesa (çmime) të reja për shërbime të reja
- Çmime (ngarkesa) të ndryshme
- Ngarkesa të reduktuara

#### **c. Ristrukturimi organizativ**

- Shqyrtimi i strukturës organizative **Organogrami i Ri**

### **Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat**

- Kontrolli për parandalimin e ndërtimit ilegal të shtëpive dhe objekteve tjera
- Zbatimi i rregulloreve komunale
- Kujdesi ndaj palëve (Hapja e Zyrës Pritëse)
- Shqyrtimi i planit të punës 2024
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës 2025
- Përgatitja e Kornizës së shpenzimeve afatmesme 2026-2027
- Përgatitja e planit urbanistik , rregullativ dhe detal
- Përmirësimi i mbledhjes thelbësore të dhënave dhe përdorimi
- Shqyrtimi i përgjegjësive dhe i obligimeve komunale
- Menaxhimi i projekteve
- Menaxhimi i bazës së të dhënave
- Monitorimi
- Vlerësimi

### **Udhëzimet kryesore nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë:**

- (a) **LIMITET** e grandeve që do t'i caktojë Qeveria Qendrore për Komuna
- (b) Buxheti duhet të jetë I **BALANCUAR**. Kjo do të thotë se Komuna **NUK MUND** të bëjë planin për shpenzime e cila tejkalon grandet e lejuara dhe nuk mund të përgatisë buxhetin deficitar.

#### **1.1. Perspektiva e politikave fiskale**

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale ( politikës së të ardhurave si nga grandit i qeverisë, të hyrave vetjake komunale si dhe shpenzimeve. Me kornizën afatmesme të shpenzimeve 2025 – 2027 është parapare ndërmarrja e një varg masash duke filluar nga kursimet në kategorinë e shpenzimeve publike – si rezultat i rekomandimeve të FMN-së e deri te marrja e masave konkrete në realizimin e të Hyrave në nivel Qendror dhe Lokal . P sh.

- Kontroll më i ngushtë dhe mbledhje e detyrueshme për ngarkesat dhe tarifatat e mbledhura në nivel lokal.
- Sensibilizim i qytetarëve për të kryer obligimet ndaj Komunës

#### **Korniza makroekonomike e Komunës është sipas Qarkores nr. 2025/01 për Komuna**

Korniza Afatmesme Makroekonomike e Komunës sonë është në përputhje me Kornizën Afatmesme Makroekonomike të Kosovës dhe dokumenteve që dalin nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH).

Në përgjithësi mund të thuhet se fondet nga Granti Qeveritar dhe Të Hyrat Vetjake Komunale për momentin nuk paraqesin potencial të mjaftueshëm financiar për zhvillimin e komunës, me që nga të hyrat e përgjithshme nuk janë mjaftueshme duke u bazuar në kërkesat sipas Drejtorive të Komunës sonë.

**BUXHETI NGA GRANTI DHE TE HYRAT VETJAKE PER VITIN 2025-2027 SIPAS  
QARKORES BUXHETORE NR. 2025 /01**

Organizata buxhetore	Aprovimi	Planifikimi	% e rritjes së buxhetit	Diferenca 2024- 2025	Projeksioni	Projeksioni
	2024	2025			2026	2027
Administrata e përgjithshme	28,389,830	30,693,901	108	2,304,071	32,494,205	34,327,340
Arsimi	19,383,401	20,247,089	104	863,688	20,854,502	21,480,137
Shendetsia	6,542,493	6,981,279	107	438,786	7,313,588	7,661,714
Fin.Q.H.Pz.Q.K.Zym Kesh. I Hoqes se madhe	51,532	54,366		2,834		
Financimi për teatro	263,947	275,065		11,118	290,194	306,155
Financimi për shërbimet rezidenciale	607,483	630,000		22,517	615,000	615,000
Huamarrja per Arsim				0		
Huamarrja per shendetesi				0		
energji ne ndertesat publike kom. Prizrenit	1,000,000	1,500,000		500,000	1,680,000	820,000
Grantet	56,238,686	58,881,700	105	2,643,014	61,567,489	64,390,346
Te hyrat vetanake	10,193,294	10,600,777	104	407,483	11,365,866	12,148,905
<b>Totali:</b>	<b>66,431,980</b>	<b>70,982,477</b>	<b>209</b>	<b>3,550,497</b>	<b>74,613,355</b>	<b>77,359,251</b>

Numri i stafit aktual ne Shkurt 2024 duke i përfshirë të gjitha kategoritë të zyrtarëve publik është 3108. Në kuadër të Administratës Komunale janë 334 persona të punësuar:

121 gra dhe 213 burra. Duke u bazuar ne kualifikimet universitare dhe profesionale si dhe pozitat drejtuese dominojnë meshkujt me 20 kundrejt 8 femrave që rrjedhimisht edhe marrin paga më të mëdha . Në kuadër të Drejtorisë së Arsimit ku janë të punësuar 2328 persona, 1379 janë gra që edhe në aspektin e përgaditjes arsimore dhe pozitave profesionale dominojnë ndërsa në pozita drejtuese prijnë burrat me 47 kundrejt 21 grave .

Në Drejtorinë e Shëndetësisë 446 persona janë të punësuar dhe këtu gjithashtu kemi dominimin e grave me 253 dhe 193 burra .Në aspektin arsimor dhe profesional përsëri dominojnë gratë, ndërsa në pozita drejtuese kemi një përafrim me 25 pozita të grave dhe 22 të burrave .

## **Parashikimi i të hyrave vetjake komunale**

Të hyrat komunale të komunës sonë realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetjake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë, të cilat të hyra duhet shpenzuar dhe ekskluzivisht dedikohen në sferën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime tjera që ju kthehen qytetarëve (tatim paguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës komunale.

### **Të Hyrat e Komunës përbëhen nga:**

- Tatimi në pronë
- Burimi i tatimit në tokë
- Taksat për ushtrim te veprimtarisë afariste
- Taksat për lejen për shërbime profesionale
- Taksa për automjete motorike
- Taksa administrative komunale
- Taksa për leje ndërtimi
- Taksa për certifikata
- Taksa për menaxhimin e mbeturinave
- Qiraja nga objektet
- Bashkë-pagesat në arsim
- Bashkë-pagesat në shëndetësi
- Renta e tokës
- Të hyra tjera<sup>1</sup>♦

## **KORNIZA KOMUNALE E SHPENZIMEVE BUXHETORE**

### **Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore**

Me vlerësimet e hershme buxhetore të shpenzimeve përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makroekonomik dhe treguesit fiskal si dhe duke pasur për bazë buxhetin e aprovuar të vitit 2024.

Kjo kornizë paraqet parashikimin tre vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale.

Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të rritjes për çdo vit si dhe të granteve të qeverisë të cilat pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve buxhetore dhe limiteve të buxhetit të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i Granteve nga MEF-i.

**VLERËSIMET SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE 2025-2027**

Programet	Planifikimi 2024	2025	2026	2027
Zyra e Kryetarit	4,322,448	4,908,873	4,968,688	5,196,949
Zyra e Kuvendit Komunal	450,000	381,560	390,000	390,000
auditori		43,325	43,329.00	43,464.00
Administrata dhe personeli	2,286,878	2,266,878	2,905,159.00	3,226,169.00
Inspektimet	416,117	304,489	344,750.00	365,020.00
Buxheti dhe financat	892,676	1,372,520	1,379,850	1,403,620
Shërbimet publike	17,212,589	18,975,168	21,096,344.00	24,377,504.00
Zjarrefiksit	1,007,340	1,048,950	1,049,240.00	862,150.00
Zyra komunale për komunitete dhe kthim	104,072	104,072	106,682.00	108,654.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvill. Rural	885,544	996,191	720,458.00	590,458.00
Zhvillimi ekonomik	661,142	627,008	646,980.00	846,980.00
Planifikimi urban dhe mjedisi	815,712	733,325	865,745.00	883,254.00
<a href="#">Shëndetësia dhe mirëqenia sociale[1]</a>	8,249,025	8,711,279	8,679,350.00	8,449,350.00
Administrata e shëndetsise	42,580	63,768	64,251.00	65,250.00
Sherbimet sociale	1,690,620	1,655,620	1,516,400.00	1,496,980.00
Sherbimet rezidenciale	404,000	600,000	619,000.00	619,000.00
Kultura, rinia dhe sportet	2,421,939	2,425,370	2,928,985.00	2,484,332.00
Teatri profesional	340,875	275,065	390,047.00	394,135.00
Arsimi dhe shkenca(sh.fill.dhe te mesme)	19,712,552	20,247,089	20,223,659.00	20,552,588.00
Administrata e Arsimit	3,106,182	3,556,581	3,800,008.00	3,975,154.00
Kadastër gjeodezi dhe pronë	179,689	185,346	194,430.00	208,240.00
<b>TOTALI</b>	<b>65,201,980</b>	<b>69,482,477</b>	<b>72,933,355</b>	<b>76,539,251</b>

70,982,477      74,613,355      77,359,251

1,500,000      1,680,000      820,000

Pas një Analize gjinore që rekomandohet të praktikohet në gjitha fushat tabelare do të vlerësohen nevojat e grave dhe burrave dhe ndikimi gjinor gjatë realizimit të projekteve komunale.

#### PARASHIKIMI I TE HYRAVE VETANAKE SIPAS VITEVE 2025-2027

Përshkrimi	2024 Plani	2025 Vlerësimi	2026 Vlerësimi	2027 Vlerësimi
b	e	f	g	
<b>TË HYRAT KOMUNALE TOTALE</b>	<b>10,193,294</b>	<b>10,600,777</b>	<b>11,365,867</b>	<b>12,148,905</b>
<b>TË HYRAT VETANAKE</b>	<b>10,193,294</b>	<b>10,600,777</b>	<b>11,365,867</b>	<b>12,148,905</b>
<b>Tatimi në pronë dhe toke</b>	<b>3,620,000</b>	<b>3,094,023</b>	<b>3,395,361</b>	<b>3,641,525.00</b>
<b>Burimi I tatimit ne tokë</b>		<b>739,305</b>	<b>864,684</b>	1,046,268.00
<b>Taksat komunale</b>	<b>5,073,294</b>	<b>5,207,449</b>	<b>5,475,822</b>	<b>5,741,112</b>
Licencat dhe lejet (taxat e bizneseve)	420,000	420,000	450,000	480,000
Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	560,000	580,000	590,000	620,000.00
Taksat e pajisjeve motorike	520,000	540,000	590,000	620,000.00
Lejet për ndërtesa	1,600,000	1,670,000	1,705,967	1,908,000.00
Taksa nga menagjimi I mbeturinave	1,773,294	1,797,449	1,789,855	1,733,112.00
Taksat tjera komunale	200,000	200,000	350,000	380,000.00
<b>Ngarkesat komunale</b>	<b>1,150,000</b>	<b>1,180,000</b>	<b>1,220,000</b>	<b>1,270,000</b>
Ngarkesat regullatore				
Të hyrat nga qiraja	450,000	480,000	520,000	570,000.00
Bashkë-pagesat për arsim	470,000	470,000	470,000	470,000.00
Bashkë-pagesat për shëndetësi	230,000	230,000	230,000	230,000.00
Ngarkesat tjera komunale (gjobat)				
<b>Të hyrat tjera</b>	<b>350,000</b>	<b>380,000</b>	<b>410,000</b>	<b>450,000.00</b>
<b>Shitja e aseteve</b>				
<b>Grantet dhe donacionet</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		
Vendore				
Të huaja				
<b>TRANSFERET QEVERTARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		
<b>Granti i përgjithshëm</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		
<b>Granti specifik për arsim</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		
<b>Granti specifik për shëndetësi</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		
<b>Grantet dhe transferet tjera</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		

Do të bëhet analiza gjinore për të përcaktuar ndikimin e strukturës gjinore gjatë parashikimit e të hyrave vetanake.

**LIMITET FILLESTARE SIPAS QARKORES BUXHETORE Nr.2025 /01 NGA  
MEF-i:**

	<b>2024</b>	<b>2025</b>	<b>2026</b>	<b>2027</b>
Granti për administratën Komunale	30,312,792	33,153,332	35,079,399	36,068,495
Granti për Arsim	19,383,401	20,247,089	20,854,502	21,480,137
Granti për Shëndetsi	6,542,493	6,981,279	7,313,588	7,661,714
<b>Gjithsej granti nga BKK</b>	<b>56,238,686</b>	<b>60,381,700</b>	<b>63,247,489</b>	<b>65,210,346</b>
Të hyrat vetanake nga Buxheti I KK-Prizren	10,193,294	10,600,777	11,365,866	12,148,905
<b>Totali I buxhetit Komunal-Prizren</b>	<b>66,431,980</b>	<b>70,982,477</b>	<b>74,613,355</b>	<b>77,359,251</b>

Nga përmbledhja e shpenzimeve për KK- Prizren shihet se për vitin 2025 janë planifikuar shpenzime prej 70.982.477 euro, sipas qarkores së parë 2025/ 01 nga MEF-i.

**PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE PËR VITIN 2025**

	KK PRIZREN (ADMINISTRATA E PERGJITHËSHME)		Stafi 2025	Pagat &Meditjet	Mallrat dhe sherbimet	Sherbimet Komunale	Subvencione &transfere	Investime Kapitale	Totali
1	Zyra e Kryetarit	granti	34	452,198				0	452,198
		te hyrat					4,500,000		4,500,000
2	Asambleja Komunale	granti		381,560					381,560
		te hyrat							0
3	Administrata dhe Personeli	granti	81	596,154	1,000,000	68,896		190,000	1,855,050
		te hyrat			221,828		0	190,000	411,828
4	Inspeksioni	granti	23	224,489	50,000				274,489
		te hyrat			30,000				30,000
5	Buxhet dhe financa (granti)	granti	41	367,520	450,000			350,000	1,167,520
		te hyrat			100,000			105,000	205,000
6a	Sherbimet PUBLIKE	granti	19	184,010	4,996,248	250,000		10,430,961	15,861,219
		te hyrat			578,289	250,000		2,285,660	3,113,949
6b	Emergenca	granti	63	548,950	30,000			400,000	978,950
		te hyrat			20,000			50,000	70,000
7	Zyra e Komuniteteve	granti	7	54,072	50,000				104,072
		te hyrat							0
8	Bujqësi, Pyltari dhe Zhvillim Rural	granti	6	59,458	243,400			553,333	856,191
		te hyrat						140,000	140,000
9	Zhvillim Ekonomik	granti	4	36,980	80,000	0		340,028	457,008
		te hyrat						170,000	170,000
10	Kadastër dhe Gjeodezi	granti	19	163,346	22,000	0			185,346
		te hyrat							0
11	Planifikimi Urban dhe Mjedis	granti	14	133,325	580,000	0			713,325
		te hyrat			20,000				20,000
13	Kulturë, Rini dhe Sport	granti	22	212,370	1,000,000			1,193,000	2,405,370
		te hyrat			20,000				20,000
14	TEATRI	granti	21	213,280			61,785		275,065
		te hyrat							0
15	Sherbimet Sociale	granti	28	255,620	600,000			400,000	1,255,620
		te hyrat			200,000			200,000	400,000
16	Sherbimet rezidenciale	granti	24	200,000	150,000	20,000		230,000	600,000
		te hyrat						230,000	230,000
	Administrata Shend.	granti	5	63,768		0			63,768
		te hyrat							0
	Administrata e Arsimit	granti	16	156,000	693,754			1,886,827	2,736,581
		te hyrat			200,000			620,000	820,000
	GRANTI I PERGJITHESHEM		427	4,303,100	9,945,402	338,896	61,785	15,974,149	30,623,332
	TE HYRAT			0	1,390,117	250,000	4,500,000	3,760,660	10,130,777
			427	4,303,100	11,335,519	588,896	4,561,785	19,734,809	40,754,109



17	Kujdesi primar shendetesor		516	4,989,350	2,015,529	206,400	0	1,500,000	8,711,279
17A	Shërbimet e kujdesit primar shendetesor (GRANTI I SHENDETSISE )	granti	516	4,799,350	1,975,529	206,400	0	1,500,000	8,481,279
	TE HYRAT E SHENDETSISE	hyrat		190,000	40,000				230,000
18	Arsim dhe shkencë		2,309	18,906,838	889,176	260,003	0	191,072	20,247,089
18A	Arsimi fillor	granti	1875	14,838,141	489,176	147,368		191,072	15,665,757
18B	Arsimi I mesem	granti	380	3,618,697		62,135			3,680,832
	Arsimi parafillor /Qerdhja e femijeve/		54	380,000		50,500			430,500
	Asistent per femije me nevoja te vecanta spec,IT;keshilltar								0
	pensionimet sipas ligjit; pagat jubilarë	granti							0
	Push.e lindjes	granti							0
	GRANTI PER ARSIM	granti	2,309	18,836,838	489,176	260,003	0	191,072	19,777,089
	TE HYRAT E ARSIMIT	hyrat		70,000	400,000				470,000
	GJITHSEJ GRANTI		3,252	27,939,288	12,410,107	805,299	61,785	17,665,221	58,881,700
	GJITHSEJ TE HYRAT			260,000	1,830,117	250,000	4,500,000	3,760,660	10,600,777
	<b>TOTALI 2024</b>		<b>3,252</b>	<b>28,199,288</b>	<b>14,240,224</b>	<b>1,055,299</b>	<b>4,561,785</b>	<b>21,425,881</b>	<b>69,482,477</b>

Buxheti sipas Qarkores 2025/01

70,982,477  
1,500,000

Në çdo Drejtori do të planifikohen shpenzimet të buxhetit duke i marrë parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave sidomos në kategoritë e investimeve kapitale dhe subvencioneve

### PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)

Programi komunal për Investime publike përfshinë të gjitha projektet e aprovuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitin 2025-2027, nga ana e Kuvendit Komunal të Prizrenit sipas proceseve buxhetore të zhvilluara dhe të aprovuara duke e marrë parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave.

Në tabelën e më poshtme paraqesim Listën e projekteve kapitale të parapara me buxhet të vitit 2024 me financim nga të hyrat vetjake si dhe nga mjetet e Grantit të destinuara për shpenzime kapitale me të dhëna për përfituesit gra dhe burra.

Gjithashtu në këtë tabelë do të paraqesim edhe projektet e planifikuara për vitin fiskal 2026-2027 nga të Hyrat vetanake të parashikuara si dhe nga mjetet e Grantit për shpenzime kapitale.

Kjo listë e planifikuar për vitin 2025-2027 mund të plotësohet edhe me projekte të tjera por edhe mund të largohen disa nga planifikimi por ky plotësim dhe modifikim i projekteve mbetet për më vonë. Këto plotësime dhe modifikime mund të bëhen nga Drejtoritë përkatëse gjatë shqyrtimeve për prioritet të Investimeve Kapitale si dhe gjatë diskutimeve me Komitetin për politikë dhe financa si dhe me struktura tjera Komunale, por gjithashtu edhe në takimet me qytetarë. Projektet janë bazuar edhe nga nevojat e paraqitura të grave, burrave dhe grupeve në nevojë

